

**VENDIM**  
**Nr.525, datë 23.4.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.666, DATË 26.10.1998 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR DISA MASA LIDHUR ME PROCESIN E LIKUIDIMIT TË**  
**NDËRMARRJEVE TË VARËSISË SË ISH-AGJENCISË QENDRORE TË**  
**RISTRUKTURIMIT DHE PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJEVE BUJQËSORE, TË**  
**NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për saksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura, dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.666, datë 26.10.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat “a” e “ç” të pikës 1 ndryshohen si më poshtë vijon:

“a) Arkëtimi i pagesave të kësteve të mbetura, të detyrimeve finaciare nga shitja e pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve bujqësore, bëhet në lekë, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.794, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurat e shitjes”.”.

“ç) debitorët privatë, për objektet ndërtimore, të kontabilizuara sipas vendimit nr.403, datë 15.8.1994 të Këshillit të Ministrave, ose për rastet e tjera, të vëna re më vonë, do t’i paguajnë detyrimet financiare, 100 për qind, në lekë.

Vlera e çdo objekti ose një pjese të tij llogaritet në bazë të vlerës kontabile fillestare, e cila pakësohet me vlerën kontabile të amortizimit (deri në çastin e zaptimit), sipas vendimit nr.401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve, si dhe të mjeteve të transportit”. Vlera e mbetur korrigjohet me koeficientin e vendndodhjes dhe me indeksin mujor të çmimeve. Ky vlerësim bëhet nga financieri ose ekonomisti i privatizimit dhe miratohet nga drejtori i drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në prefekturën përkatëse.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Privatizimi i pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve, në varësi të ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore (AQRPNB), e cila nuk është e klasifikuar dhe e trajtuar sipas vendimit nr.403, datë 15.8.1994 të Këshillit të Ministrave, të bëhet sipas vendimeve nr.794, datë 21.11.2007 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurat e shitjes”, dhe nr.850, datë 21.11.2007 “Për kriteret dhe procedurat e shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo të objekteve shtetërore të veçuara, të privatizuara” të Këshillit të Ministrave.”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**